

## **AKT THEMELIMI I SHOQERISE "ORIENTE 51" SHPK**

Mbështetur ne Kushtetutën dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikës se Shqipërisë , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private , nismës se lire dhe te veprimtarisë private dhe privatizimit”, te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, “Për shoqëritë tregtare” dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 “Për Q.K.B dhe formalitetet qe duke respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tij te lire, te shprehur edhe ne nënshkrimin e këtij akt-themelimi nga ortaku:

1. Massimo BORTONE lindur më 07.07.1954, në OTRANTO (LE) me Pasaportë Nr. YA6872672;
2. Francesco BORTONE lindur më 09.12.1951, në OTRANTO (LE), me Kartë Identiteti Nr. CA26538GT;

individë dhe shoqëri me zotësi të plotë juridike për të vepruar, banues në Vlorë, të krijoj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar “**ORIENTE 51**” shpk me akt themelimi si vijon:

### NENI 1

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur “**ORIENTE 51**” shpk. Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë Dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit te shoqërisë që do të miratohen nga të tre ortakët themelues:

1. Massimo BORTONE lindur më 07.07.1954, në OTRANTO (LE) me Pasaportë Nr. YA6872672;
2. Francesco BORTONE lindur më 09.12.1951, në OTRANTO (LE), me Kartë Identiteti Nr. CA26538GT;

### NENI 2

Shoqëria “**ORIENTE 51**” sh.p.k ka qendrën në Vlorë, Tregu me Shitje Shumicë Fruta-Perime sh.a., Jalli, Nartë dhe do të ketë të drejtë të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë..

Shoqëria mund të ndryshoj selinë e saj, të hap zyra përfaqësie, degë, të krijoj filiale brenda Republikës se Shqipërisë dhe jashtë saj, vetëm me vendim të ortakëve.

### NENI 3

#### **Veprimtaria e Shoqërisë “ORIENTE 51” Sh.p.k, do të ketë për objekt:**

Real-Estate, Shitblerjen, dhënien dhe marrjen me qira dhe nënqera të objekteve ndërtimore apartamente afatgjatë ose sezonal, ndërtimin, operimin si dhe ofrimin e konsulencës si dhe cdo aktivitet tjetër lidhur me menaxhimin e pasurive të paluajtshme dhe objekteve turistike dhe cdo aktivitet tjetër në fushën e hoteleri turizmit.

Shoqëria mund të kryej cdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme apo te paluajtshme si dhe cdo aktivitet tregtar, financiar, qeradhënieje apo hipoketimi, të cilat mund të konsiderohen si të dobishme apo të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë.

Turizëm, këshillues dhe hartues planesh turistike. Menaxhim ndërmarrjesh turistike dhe industriale të të gjitha llojeve. Hoteleri, sherbime te restoranterise, sherbime catering, bar-kafe, organizim dhe menaxhim plazhe private, agroturizem, organizim eventesh dhe çdo siper marrje tjetër ne fushen e turizmit.

Të blej në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthorte interesa në shoqëri të tjera me objekt të ngjashëm me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj, dhe të kryejë cdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm në mënyrë arritjen e objektit të Shoqërisë. Shoqëria duhet të kryejë cdo aktivitet që përfshihet në objektin e saj, në lidhje dhe që e favorizon atë. Shoqëria duhet të respektoj të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse. Ajo përfshin standartet më të mira etike.

Tregtimin me pakicë dhe shumicë i artikujve të ndryshëm ushqimore dhe joushqimore si dhe importimin dhe eksportimin e tyre. Kryerja e cdo lloj aktiviteti që lidhet me veprimtarinë e agjentit, brokerit, komisionarit, ndërmjetësit pa u kufizuar nga veprimtaria që kryhet nga porositësi apo cdo palë tjetër e tretë. Shfrytëzimin ekonomik regjistrimin dhe administrimin në cdo lloj forme të teknologjive, disenjove, markave, licencave, produkteve, pamjeve grafike si dhe cdo produkti tjetër. Kryerjen e veprimtarive të kërkimit dhe zhvillimit si pjesë e projekteve që sjellin risi ligjore, ekonomike, financiare apo teknologjike, të kryera me qëllim përfitimin e financimeve apo komisioneve nga palët e tretë.

Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, Shoqëria ka të drejtë: të mundësoj trajnime profesionale për punëmarrësit e saj apo palë të tretë; të kryejë cdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregtar, financiar dhe industrial, dhënie-marrje me qira, të vendosë pengje, hipotekë dhe cdo barrë tjetër siguroese që mund të konsiderohen si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë; të kryejë cdo aktivitet në lidhje me publikimin, marketingun apo reklamimin; të zotërojë kuota/aksione apo cdo lloj interesi tjetër në shoqëri të tjera, pavarësisht fushës në të cilën kryejnë veprimtari këto shoqëri. Shoqëria kryen cdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e favorizon atë.

Ndërtim, tregti brenda dhe jashtë vendit i artikujve të ndryshëm, ndërtim dhe tregtim i impianteve dhe sistemeve elektro-industriale, strukturave mbështetëse, si dhe i veprave civile relevante. Import eksport i makinerive bujqësore dhe i pjesëve të këmbimit për to.

Ndërtim lulishtesh, mirëmbajtje lulishtesh, shitje lulesh, pemësh frutore dhe dekorative.

Marketing dhe hartim planesh marketing. Shërbim konsulence në fushat e kontabilitetit dhe financës. Shitje dhe qeradhënie objektesh ndërtimore, apartamente, hotele, etj. Blerje dhe shitje ndërmarrjesh të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Veprimtari në fushën e transportit kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave. Veprimtari në fushën e mjedisit dhe agroturizmit.

Veprimtari në fushën e ndërtimit, montimit të impianteve të përpunimit të prodhimeve bujqësore, blegtorale, prodhimeve të detit, etj.

Veprimtari në fushën e marketingut të prodhimeve agroindustriale, bujqësore, blegtorale, mjedisore, ndërtimit, makinerive, pajisjeve, etj, të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me agroindustrinë, mjedisin, transportin, etj.

Veprimtari financiare në fushën e mbështetjes së bashkëpunimit të fermerëve, kooperativave 2 bujqësore dhe organizmave të tjera vendit dhe ndërkombëtare të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me sektorët e agroindustrisë, agroturizmit, mjedisit, peshkimit, etj.

#### NENI 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është me afat nga 06.12.2021 deri në një afat të pacaktuar.

#### NENI 5

Kapitali i shoqërisë është LEKE **6.000.000** (*gjashtë milion lek*) lek.

Kapitali është i ndarë në **2** kuota, njëra me vlerë **5.400.000** (*pesë milion e katër qind mijë lek*) lekë dhe tjetra me vlerë 600.000 (*gjashtëqind mijë lek*) lek.

Kapitali i shoqërisë ndahet sipas ortakëve:

1. Massimo BORTONE lindur më 07.07.1954, në OTRANTO (LE) me Pasaportë Nr. YA6872672, 90% (*nëntëdhjetë përqind*) ose 1 (*një*) kuotë për 5.400.000 (*pesë milion e katër qind mijë lek*) lek;
2. Francesco BORTONE lindur më 09.12.1951, në OTRANTO (LE), me Kartë Identiteti Nr. CA26538GT, 10% (*dhjetë përqind*) ose 1 (*një*) kuotë për 600.000 (*gjashtëqind mijë lek*) lek;

Kapitali i shoqërisë mund të rritet apo zvogëlohet me vendim të ortakëve.

#### NENI 6

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, i përcaktuar me Vendim të Ortakëve.

#### NENI 7

Të ardhurat e Shoqërisë ju takojnë Ortakëve në proporcion me përqindjet e kuotave të kapitalit themeltar.

#### NENI 8

Ortakët e shoqërisë mund ta shkarkojnë administratorin në çdo kohë me vendim të arsyetuar. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund ta parjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Ortakët me vendim përcaktojnë edhe një ekspert kontabël të miratuar, i cili është përgjegjës përpara kësaj shoqërie për dëmet që mund të shkaktojë nga moskryerja në rregull e detyrës së tij.

#### NENI 9

Administratori ka të drejtë të caktojë dhe revokojë persona të tretë në mungesë dhe për llogari të tij.

#### NENI 10

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### NENI 11

Shoqëria do të ketë Vulën dhe Logon e vet.

#### NENI 12

Akti i themelimit u përpilua në 5 kopje, një kopje për tju dorëzuar organeve kompetente, nga një kopje Ortakëve të Shoqërisë dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë

Akti i Themelimit nënshkruhet prej ortakëve të shoqërisë në datë 06/12/2021.

### ORTAKET E SHOQERISE

Massimo BORTONE



Francesco BORTONE

